

## Kompjuterat në dispozicionin tuaj



Bibliotekat bashkiake vënë në dispozicionin tuaj rreth 700 kompjutera. Nëpërmjet tyre ju mund të lidheni falas dhe në mënyrë të sigurt me internetin dhe mund të përdorni softë të ndryshme (trajtim teksti, retush fotografish) sipas përdoruesve (fëmijë, të rritur)...

## Kompjuterat që mund të përdoren lirshëm

### Për kalimtarët e rastit

Kompjuterat e ashtuquajtur « të rastit » koha e përdorimit të të cilëve kufizohet prej **15 minutash**, janë të disponueshëm në bibliotekat e Parisit pa qenë të regjistruar

### Për personat e regjistruar

Kompjuterat janë në dispozicion të përdoruesve të pajisur me kartën e regjistrimit brenda afatit të vlefshëm të përdorimit.

Kompjuterat « për të rritur » mund të përdoren vetëm nga personat mbi 12 vjeç. Kompjuterat « Për të rinj » nuk mund të përdoren nga personat që janë mbi 18 vjeç.

### Identifikimi

L'identifikuesi është numri i përdoruesit që figuron mbi kartën personale lëshuar në momentin e regjistrimit në bibliotekat e Qytetit të Parisit që japin hua. Password është data e lindjes e shkruar në këtë formë ddmmvvv (shëmbull : 16021979).


### Kohëzgjatja e përdorimit

Janë parashikuar disa kohëzgjatje :

- duke filluar nga 12 vjeç: 2 orë në ditë nga e marta në të dielë
- për ata që janë më pak se 12 vjeç: 1 orë në ditë nga e marta në të dielë

## Rezervimi i kompjuterave

Duke filluar nga vjeshta e vitit 2015, në disa biblioteka do të vendoset një shërbim rezervimi i kompjuterave. Lista do të jetë e disponueshme së shpejti në këtë faqe. Kompjuterat që mund të rezervohen mbeten në dispozicion edhe pa rezervim dhe i nënshtrohen të njëjtave kushteve përdorimi. Kompjuterat mund të rezervohen deri 14 ditë përpara përdorimit.

 Nëse brënda 4 javëve keni bërë 3 rezervime dhe nuk i keni respektuar, përdorimi i këtij shërbimi do t'ju pezullohet përkohësisht. Për informacione të mëtejshme për rezervimin e kompjuterave, drejtojeni bibliotekës tuaj.

## Shërbimet

Midis shërbimeve që ju propozohen për kompjuterat, do të gjeni:

- Lidhja me internetin me debit të lartë dhe të sigurt
- Programe për trajtimin e teksteve, tabela etj (LibreOffice)
- Disa programe të lira në fusha të ndryshme (vizatim, retushimin e fotografive, muzikw, video, astronomi, kimi)

Është e mundur ta ruani punën tuaj duke e regjistruar në një çelës USB ose duke e dërguar në një adresë elektronike.

Nuk ka printer në dispozicionin tuaj.

## Angazhimi i përdoruesit të kompjuterave publikë të bibliotekave të Parisit

Kompjuterat publikë janë vënë në dispozicion nga bibliotekat e Qytetit të Parisit ndaj dhe përdoruesit duhet t'i nënshtrohen rregullores së këtyre bibliotekave.

I kërkohet përdoruesit të bëjë kujdes ndaj materialit të vënë në dispozicionin e tij dhe veçanërisht ndaj elementeve të brishta si ekrani, tastiera, mausi dhe kaska.

Mbi të gjitha llojet e kompjuterave, përdoruesi nuk duhet :

- të vë apo të heqë nga priza kabllo të ushqyes dhe telat që lidhin pjesët e ndryshme të kompjuterit.
- të tentojë të lidhë materialin e tij me kompjuterin, përveç një çelësi USB në vendin e parashikuar dhe një kaskë audio në prizën e tipit jack të parashikuar për këtë gjë.
- të tentojë të ndyshojë më çfardo lloj mënyre konfigurimin material dhe softin e kompjuterit ;
- të tentojë të futet në shërbime apo burime që nuk propozohen nga bibliotekat ;
- të tentojë të instalojë programe informatike apo të përdorë programe informatike jashtë mjedisit informatik të vënë në dispozicion.
- të tentojë të futet në pajisjet me të cilat është lidhur në rrjetin e kompjuterit që përdoret
- të tentojë të shmangë dispozitivin e filtrimit.

Mbi kompjuterat me indentifikim, përdoruesi nuk duhet :

- të përdorë numrin e identifikimit të një përdoruesi tjetër ;
- t'i lejojnë një personi tjetër të përdorë numrin e tij të identifikimit ;
- të bëjë kërkesë për material kompensues nëse nuk vuan nga një handicap i dëgjimit apo i shikimit .

Mbi kompjuterat që nuk kanë identifikues, kur përdoruesi të cilit i është vënë kompjuteri në dispozicion ka mbaruar sesionin e tij, ai duhet t'i lëshojë vendin përdoruesit tjetër.

## Dispozitat ligjore dhe rregulloret

Si sistem informatik, Sistemi multimedia i bibliotekave të Qytetit të Parisit i nënshtrohet një sërë dispozitash ligjore dhe rregullore mos respektimi i të cilave ndëshkohet penalisht. Ndëshkimi shkon nga gjoba deri në burgim.

Ju kujtojmë që këto dispozita përfshijnë midis të tjerash :

- Mbrojtjen e minorenëve: Bibliotekat e Qytetit të Parisit që japin hua, janë të hapura për të gjithë. Si të tilla, është e ndaluar të konsultohen site në të cilat ka dhunë, site pornografike apo site që mund të prekin dinjitetin e njeriut të cilat mund të shihen nga të miturit. Gjithashtu, konsultimi i siteve të cilët vënë në skenë të mitur ndalohet dhe ndëshkohet penalisht (nenet 227-23 dhe 227-24 të Kodit Penal).
- Hilja informatike : « Të futesh apo të mbash me hile një pjesë apo të gjithë sistemin (...) të pengosh apo të dëmtosh funksionimin e një sistemi (...) të fusësh, të fshishë apo të ndryshosh të dhënat që ai përmban përbëjnë vepra penale. Tentativa e këtyre veprave penale ndëshkohet me të njëjtat dënime. » (nenet 323-1 à 7 të Kodit Penal).
- Të drejtat e autorëve : Kodi i pronës intelektuale ndëshkon falsifikimin dhe në mënyrë të përgjithshme çdo cënim të të drejtave të autorëve. Me përjashtim të një përdorimi privat, çdo ripërdorim i një vepre apo një krijimi të mendjes është i ndaluar pa autorizimin paraprak të autorëve apo të trashëgimtarëve të tyre.

## Organizimi i përdorimit të kompjuterave dhe sjelljet e përdoruesve

Një përdorues që nuk respekton këto kushte përdorimi apo që kërkon t'i përdorë për qëllime të tjera mund të përjashtohet dhe t'i ndalohet përdorimi i vëndeve publike të bibliotekave të Qytetit të Parisit. Një denoncim mund të bëhet kundër tij.